




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilmen/Prodato Received/Delivery	11.05.2021	viti god year	
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHEK	2340/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. Nr.193/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Clirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.193/2021 të datës 25.03.2021, të parashtruara nga me adresë banimi rruga " Xhevat Berisha", PN, Prizren, kundër organit të punësimit Komuna e Prizrenit, në çështjen juridik "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 47 dhe 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 11.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.193/2021 të datës 25.03.2021, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi Zyrtar Administrativ në Komunën e Prizrenit, me datë 25.03.2021 ka parashtruar në formë elektronike ankesë me numër protokolli 1404/2021 e regjistruar me datë 26.03.2021 me numër A.nr.193/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Komunës së Prizrenit për shkak të mos harmonizimit të koeficientit të pagës për pozitën e Zyrtarit Administrativ.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.03.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses të Komunës së Prizrenit. Ndërsa Këshilli me datë 21.04.2021, ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankuesit me numër protokolli 1938/2021 nga Komuna e Prizrenit se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 193/2021, e datës 26.03.2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimi i datës 01.04.2019, i ankuesit Akt Emërimi i datës 02.02.2020 i ankuesit, Shkresa e datës 01.08.2018 e DASHC për harmonizim të koeficientit të pagës për punëtorët e Administratës së Komunës së Prizrenit, Kërkesa e datës 21.09.2020 dërguar përmes e-mailit, Përgjigje në ankesë me numër protokollit 1938/2021 e datës 21.04.2021, Konkursi i datës 19.10.2018; lista e pagave prej datës 01.10.2018, deri me datën 21.10.2018, provat shtese të datës 29.04.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha se bashku, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është parashtruar jashtë afatit ligjor, *sepse,*

Nga shqyrtimi i provave të lëndës Kolegji ka gjetura se ankuesi nga data 01.04.2019 ka themeluar marrëdhënie pune më Komunën e Prizrenit, në pozitën e Zyrtarit Administrativ, Sektori i Shërbimit Profesional për Punë Financiare dhe Administrative, në kuadër të Departamentit të Shëndetësisë, ndërsa me datë 21.09.2020 i njëjti ka parashtruar kërkesë për harmonizim të koeficientit të pagës nga pesë(5) në gjashtë (6).

Në ankesën e parashtruar në Këshill, ankuesi pretendon se organi i punësimit, respektivisht Komuna e Prizrenit me mos harmonizimin e koeficienti të pagës ka bërë diskriminim në raport me ankuesin. Me tutje shton se në kuadër të Komunës së Prizrenit gjejmë në një drejtori tjetër është hapur konkurs me koeficient gjashtë (6), për të njëjtën pozitë me detyra dhe përgjigjes të njëjta. Kërkon që Këshilli ta aprovoj në tërësi ankesën dhe ta detyroj Komunën e Prizrenit që ankuesit ti bëjë harmonizimin e koeficientit të pagës nga pesë(5) në gjashtë (6), dhe ti kompensoj në mënyrë retroaktive diferencën e koeficientit nga data e themelimit të marrëdhënies së punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht në kërkesën e ankuesit të datës 21.09.2020 drejtuar Udhëheqësit të Sektorit të Shëndetësisë, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se ushtrimi i ankesës me datë 25.03.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda Nr. A. Nr. 193/2021

Çlirim ZEKA

Çlirim ZeKa
Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ DEMI



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit ;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit;
- Arkiviot të KPMSHCK-së

